



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE

Kavajë, më 15.01.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr.1 datë 15.01.2025

“PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND NGA FONDI I KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË KAVAJË, PËR MUAJIN Dhjetor 2024”

Në mbështetje të Ligjit 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, I ndryshuar; Ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, I ndryshuar ; Ligjit nr.84/2022, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”; Ligjit 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” indryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.68, dt.23.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Kavajë për vitin 2025”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.2 dt.29.01.2024 “Për miratimin e kriterëve për dhënie të ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, si dhe për ato, që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor”, si dhe referuar relacionit permbledhës, Drejtoria e Shërbimit Social me propozim të kryetarit të Bashkisë, i paraqet Këshillit Bashkiak:


TË VENDOSI:

- 1.Miratimin e listës përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për ndihmën ekonomike për muajin **Dhjetor 2024**, sipas listës bashkëlidhur, **Nr. Familjeve 4 , fondi 17563 lekë.**
- 2.Miratimin e listës së familjeve përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% nga buxheti i Bashkisë Kavajë,për muajin **Dhjetor 2024**, sipas listës bashkëlidhur, **Nr.familjeve 85, fondi 315941 lekë.**
2. Efektet financiare të këtij vendimi, do të mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale për 6% e sistemit, dhe nga buxheti Bashkisë Kavajë , llogaria “Transferte në buxhetet familjare”.
- 3.Ngarkohen Drejtoria e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Shërbimit Social,Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe PAK, dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

4.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015,

Drejtor e burimeve ekonomike

Andi ÇURGU




Drejtor i Shërbimit Social

Xhulja UZUNI



Drejtorja e burimeve ligjore

Adrian MALAJ




Sekretari i Këshillit Bashkiak

Meri BITURKU



KRYETARI

Fisnik QOSJA



BASHKIA KAVAJE
SEKSIONI I NDIHMES EKONOMIKE

NDIHMJA ME FONDET E BASHKISE

2025	Kavaje		Synei		Golem		Luz I vogel		Helmes		T O T A L I	
	Nr	Fondi	Nr	Fondi	Nr	Fondi	Nr	Fondi	Nr	Fondi	Nr	Fondi
Mujit												
Dhjetor 2024	66	245998	3	14700	8	27323	8	27920	0	0	85	315941
Janar 2025									0	0	0	0
Shkurt 2025									0	0	0	0
Mars 2025									0	0	0	0
Prill 2025									0	0	0	0
Maj 2025									0	0	0	0
Qershor 2025									0	0	0	0
Korrik 2025									0	0	0	0
Gusht 2025									0	0	0	0
Shtator 2025									0	0	0	0
Tetor 2025									0	0	0	0
Nentor 2025									0	0	0	0
		0		0		0		0		0		0
		245998		14700		27323		27920		0		315941